



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Integrimi i komunitetit

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Të nxitet dhe të përfshihet komuniteti në projektin e punës së fëmijëve.



Përfundimi: Realizimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për punën e fëmijëve në kuptimin më të gjerë të fjalës. Përfshirja e grupeve të tjera që të tërhiqet vëmendja dhe interesi kundrejt projektit për punën e fëmijëve. Fuqizimi i rolit të të rinjve si forcë lëvizëse për ndryshime shoqërore.

Koha

2 – 3 orë mësimi

Nuk është e lehtë të përcaktosh kohën e saktë të kësaj veprimtarie, e cila varet nga rrethanat dhe nga ajo që ju dëshironi të realizoni për ndërgjegjësimin. Mund të zgjidhni të realizoni një ditë të caktuar që do ta quani "Dita e punës së fëmijëve" ose të zgjidhni të bëni "Javën e punës së fëmijëve", gjatë së cilës ju do të zhvilloni shumë veprimtari me këtë temë. Gjithësesi, duhet të keni parasysh se pjesa më e madhe e veprimtarive të tilla kërkon një planifikim të hollësishëm deri në detaje.



Shënim për përdoruesin

Ju këshillojmë që ky modul të zhvillohet në fund, meqë përbën kulmin e të gjitha veprimtarive që ju dhe grupi juaj ka bërë gjatë moduleve të mëparshme. Një ndër objektivat themelore të SCREAM-it është përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Ky modul i ndihmon ata që dëshirojnë të zhvillojnë këtë koncept dhe të luajnë një rol konkret në lëvizjen shoqërore për ndryshime shoqërore. Për ta kjo mund të jetë një përvojë shumë e dobishme dhe entuziaste. Ia vlen që të shfrytëzohet ky rast.

Motivimi



Modulet e SCREAM-it janë konceptuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfshirjen aktive të të rinjve në fushatën botërore kundër punës së fëmijëve. Falë veprimtarisë ndërgjegjësuese në rritje të projektit, të rinjtë do të bëhen më përgjegjës dhe do t'u trasmetojnë mesazhe të forta bashkëmoshatarëve, familjeve dhe komunitetit. Gjatë realizimit të moduleve, të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen për rolin që duhet të luajnë në luftën kundër punës së fëmijëve dhe një pjesë e këtij roli është që ata të ndërgjegjësojnë të tjerët për rëndësinë e kësaj lufte dhe t'i bëjnë edhe këta bashkëpunëtorë dhe mbështetës të tyre për të ndihmuar fëmijët që punojnë në të gjithë botën.

Ka mënyra të ndryshme për të përfshirë komunitetin në programin SCREAM. Gjatë zhvillimit të moduleve të mëparshme, duhet të keni zbuluar disa prej tyre. P.sh., kemi folur për mbështetje të jashtme në realizimin e modulit, që nënkupton përfshirjen e prindërve apo të pjesëtarëve të tjerë të komunitetit të ndihmojnë në zhvillimin e modulit. Ju këshillojmë, gjithashtu, të ftoni politikanë, përfaqësues të sindikatave, të OJF-ve, ekspertë të fushës ekonomike etj., që t'u flasin të rinjve rreth çështjeve të caktuara ose të vëzhgojnë dhe të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme. Bëhet fjalë të punohet me mjetet e komunikimit dhe të përgatitet një fushatë mediatike. Dhe moduli "Dramatizimi" është konceptuar në mënyrë të tillë që të përfshijë me frytshmëri komunitetin. Të rinjtë nxiten të luajnë në teatër për njerëz, duke dhënë kështu mesazhin që duan t'i përcjellin publikut. Këshilla të tjera për përfshirjen e komunitetit përmbledhen në udhëzuesin për realizimin e modulit.

Ky modul synon t'ju ndihmojë, ju dhe grupin tuaj, të organizoni një veprimtari të posaçme ndërgjegjësuese apo një seri veprimtarish. Në shtesën nr.1 do të gjeni veprimtari të posaçme ndërgjegjësuese për komunitetin, si dhe një rast konkret që është zhvilluar gjatë eksperimentimit të modulit në Republikën e Irlandës.

Përgatitja

Ka mënyra të ndryshme për të ndërgjegjësuar komunitetin. Disa prej tyre përshkruhen në detaje në shtesën 1. Veprimtaritë që do të zgjidhni, kushtëzohen nga koha dhe mjedisi ku do të zhvillohen. Veprimtaria që do të vendosni të zhvilloni, do të kushtëzohet nga faktorë të tillë, si: tradita, kultura, burimet financiare, përkushtimi dhe motivimi etj. Gjithësesi, thelbi i kësaj veprimtarie është që të përfshijë aktivisht të rinjtë në zhvillimin e saj.

Disa prej veprimtarive mund të realizohen shumë mirë nëse përfshihen në të edhe persona të jashtëm që bëjnë pjesë në komunitet. P.sh., nëse të rinjtë dëshirojnë të zhvillojnë një koncert ose të përgatisin një figurë me letër etj., mund të kërkojnë ndihmën e mësuesit të muzikës, të mësuesit të vizatimit të shkollë ose të ndonjë piktori apo skulptori që banon në këtë komunitet. Nxitini të rinjtë të takohen me pjesëtarë të komunitetit dhe t'u kërkojnë ndihmë për të shfrytëzuar profesionin e tyre në të mirë të ndërgjegjësimit të komunitetit.

Nëse në realizimin e moduleve të mëparshëm keni aktivizuar ndonjë artist, kërkojini përsëri të bëhet pjesë e grupit tuaj dhe bashkëpunoni me të.

Muzika, kënga dhe kërcimi janë mjete të ndërgjegjësimit. Muzika, për karakteristikat që ka, është në gjendje t'i mbledhë të gjitha grupet e njerëzve, pavarësisht shtresës shoqërore, profesionit, mjedisit ku këndohet, duke krijuar një klimë harmonie dhe kënaqësie. Muzika dhe kënga janë përdorur me sukses nga programi i IPEC-ut, siç ka ndodhur në rastin e këngës "Çlirojini fëmijët", që është kompozim i një nxënëseje franceze e shkollës "Gabriel Péri", si dhe koncertet e orkestrës "Suzuki" e Torinos në Itali. Në këtë mënyrë të rinjtë dhe fëmijët mund të prekin zemrat e atyre që kanë të drejtë të marrin vendime.

Në shtesën nr.1 do të gjeni një shembull si historianët dhe përfaqësues të botës akademike lokale u përfshinë në një program ndërgjegjësimi për komunitetin. Persona të tillë duhet të përdoren në tryezat e rrumbullakta, në mjetet e komunikimit masiv, si dhe në



konferencat e organizuara me komunitetin. P.sh., grupi juaj mund të ftojë një ndër këta personazhe të marri pjesë në shitjen e vizatimeve të fëmijëve të shkollës fillore me temë "Puna e fëmijëve".

Në komunitet ka persona me interesa shumë të gjera dhe profesione të ndryshme, të cilët do të jenë të kënaqur të marrin pjesë dhe t'i përgjigjen pozitivisht kërkesës së të rinjve për t'u përfshirë në realizimin e projekteve me temë sociale apo që kanë të bëjnë me zhvillimin. Nga ana tjetër, të tilla veprimtari do të përmirësojnë aftësitë komunikuese të të rinjve të grupit.

Tërhiqni vëmendjen e të rinjve për rëndësinë që kanë mjetet e komunikimit në trasmetimin e veprimtarive ndërgjegjësuere. Këshillojini ata të shfrytëzojnë njohuritë dhe shprehjet e fituara gjatë realizimit të modulit për mjetet e komunikimit, pasi do të jenë të vlefshme për të komunikuar me median gjatë realizimit të veprimtarive të veçanta.



Veçanërisht thojuni të rinjve të jenë bindës dhe të aftë në takimet me mjetet e komunikimit. Përdorimi i mjeteve të komunikimit për të bërë lajmërimë apo spote publicitare, mund të jetë i kushtueshëm. Por nëse të rinjtë janë të shkathët dhe dinë të shfrytëzojnë njohjet e tyre, mund të jenë bindës dhe t'i mbushin mendjen ndonjë gazetari apo botuesi etj., që në gazetën apo emisionin që ka, të krijojë hapësirën e duhur për projektin. Të kërkosha diçka, nuk të kushton asgjë, por ndaj një dukurie të tillë, siç është puna e fëmijëve, gjasat janë që media të reagojë pozitivisht dhe të ndihmojë. Kjo mund të shërbejë si fillimi i një bashkëpunimit të ngushtë që do të promovojë veprimtaritë dhe projektin.

Veprimtaria 1. Aktivitete ndërgjegjësuere

1-2 orë mësimi për të shkëmbyer mendime dhe për të përgatitur veprimtarinë si dhe koha që duhet për ta zhvilluar atë.

Mblidhni mendimet e pjesëtarëve të grupit. Duke bërë këtë gjë, do të zbuloni se të rinjtë kanë shumë ide origjinale në lidhje me veprimtaritë ndërgjegjësuere dhe do t'ju duket se janë shumë të prirur për të zhvilluar një veprimtari të tillë. Pasi të keni marrë në shënim idetë, diskutojini një për një nga këndvështrimi i mundësisë së realizimit, përparësitë që paraqiten, dhe të pranueshmërisë së tyre nga ana e publikut.

Grupi duhet të jetë përgjegjës jo vetëm për të dhënë ide, por edhe për t'i çuar ato deri në fund, pra për t'i realizuar ato.

Në vijim do t'ju japim disa këshilla për veprimtaritë ndërgjegjësuese. Shtesa 1 është e vlefshme, pasi nxit idetë dhe ju bën të mendoni për realizimin e tyre praktik. Nuk bëhet fjalë për një listë me zgjidhje përfundimtare, por do të jetë e dobishme për të gjallëruar diskutimin dhe për të nxitur shpalosjen e ideve të reja në grup.

- Për realizimin e veprimtarive ndërgjegjësuese zgjidhni një ditë të veçantë. P.sh., një ditë e tillë është “Dita kundër punës së fëmijëve” (më 12 qershor). Mundësi të tjera janë dita e votimit të diçkaje të rëndësishme nga këshilli bashkiak i qytetit apo nga parlamenti, ditë të veçanta të shpallura nga Kombet e Bashkuara, p.sh., festa e punëtorëve (1 Maji), dita e të drejtave të njeriut, festa e nënës, dita e mësuesit. Përgatitja e veprimtarive ndërgjegjësuese pranë këtyre ngjarjeve ndihmon të kenë një ndikim të fuqishëm në komunitet.
- Bisedoni me mësues dhe nxënës të shkollave fillore për punën e fëmijëve. Biseda të tilla, në praninë tuaj, mund të drejtohen nga të rinjtë e grupit, mësuesit e klasës, prindër apo dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit. Më pas mund të krijohen këngë dhe vjersha për punën e fëmijëve, të cilat mund të interpretohen në ngjarje dhe situata të caktuar për komunitetin. Një mënyrë tjetër është që grupi të zhvillojë një veprimtari të tillë gjatë gjithë ditës në një shkollë fillore. Gjatë kësaj dite me temën e punës së fëmijëve nxënësit mund të bëjnë vizatime, si dhe punime të tjera artistike, të cilat më pas mund të ekspozohen në vende të dukshme për komunitetin apo dhe të shiten për të mbledhur fonde në mbështetje të projekteve për menjanimin e plotë të punës së fëmijëve apo për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve që shfrytëzohen.
- Ndërtoni një statujë me përmasa të mëdha që tregon fëmijën që punon dhe ekspozojeni në mjedise të populluara që të shikohet nga komuniteti dhe nga shkolla. Ajo çka duhet të shprehë kjo statujë, është gjithçka negative dhe e dëmshme që lidhet me punën e fëmijëve. Veprimtaria përfundimtare duhet të parashikojë shkatërrimin e kësaj statue nga të rinjtë, si shenjë simbolike për menjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Shkatërrimi i statujës do të përfaqësojë zëmërimin e të rinjve ndaj kësaj dukurie, si dhe



zëmërimin ndaj atyre që janë indiferentë apo ndikojnë në shfrytëzimin e punës së fëmijëve. Kjo statujë duhet të bëhet me një material që prishet lehtësisht, si, p.sh., papie mashe (copa letre të ngjitura me ngjitëse). Grupi mund të organizojë një ceremoni, gjatë së cilës të flitet për punën e fëmijëve, për vuajtje dhe shfrytëzimin e tyre. Në përfundim të saj të ftojë edhe pjesëtarë nga publiku që të shkatërrojnë së bashku statujën si simbol i shfrytëzimit të fëmijëve nëpërmjet punës.

- Mundohuni të mblidhni sa më shumë fëmijë e të rritur për t'i bërë pjesë e veprimtarisë suaj. Zgjidhni një ditë që mund të mblidhni shumë fëmijë e të rritur që të formojnë një varg të gjatë, i cili të rrethojë, p.sh., shkollën apo bashkinë etj. Ky varg do të përfaqësojë fëmijët që punojnë. Disa prej tyre do të mbajnë të varura pankarta ku shkruhet se numri i fëmijëve që punojnë sot në botë, është me qindra mijë më shumë. Pankarta të tjera mund të sjellin statistika të sakta të numrit të fëmijëve që punojnë. Ky varg mund të lëvizë gjatë rrugës duke kënduar një këngë që i kushtohet punës së fëmijëve, duke tërhequr kështu vëmendjen e komunitetit.
- Pjesëtarë të këtij vargu duhet të hyjnë në dyqane të ndryshme dhe t'i pyesin shitësit nëse e dinë që një pjesë e mallrave që tregtojnë, janë fryt i punës së fëmijëve. Kjo veprimtari mund të bëhet në formën e një sondazhi apo duke takuar edhe përgjegjësit e dyqaneve. Qëllimi është që i gjithë komuniteti, punëdhënësit, sindikatat, shitësit etj., të ndërgjegjësohen për mënyrën si prodhohen mallrat që tregtojnë. Sjellja e të rinjve nuk duhet të jetë agësive, joprovokuese, por një sjelle e rregullt, gjithë edukatë. Mos u nisni me qëllimin që të krijoni skena brutale.
- Krijoni dhe realizoni një kartolinë që ka si temë punën e fëmijëve, përgatitni kopje të saj sa më shumë të jetë e mundshme. Kartolina t'u dërgohet pushtetarëve në nivel lokal apo kombëtar dhe të përmbajë një mesazh për vëmendjen që këta duhet të tregojnë ndaj punës së fëmijëve me veprime konkrete që duhet të ndërmerren. Grupi të takojë pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit, të vizitojë shkolla dhe t'u shpjegojë kuptimin e kartolinës. Në përfundim të kërkojë solidarizimin e tyre duke nënshkruar në kartolinën që do t'u dërgohet pushtetarëve. Kartolina mund të jetë bërë në një karton të ngjyrosur me ngjyra të ndezura për të tërhequr vëmendjen, apo mund të jetë një vizatim i bukur fëmijësh. Një variant tjetër është që të realizohet një



kartolinë gjigande në copa, ku secila prej tyre të jetë pjesë e një pazëlli. Për rrjedhojë, pushtetari që do ta marrë, për të kuptuar domethënien, duhet të ndërtojë pazëllin. Për këtë temë ka variante të ndryshme realizimi.

- Punoni me grupin për të përgatitur një fletëpalosje, e cila të ketë hapësira të mëdha të paplotësuara. Me to shkoni në shkollën fillore dhe kërkojuni fëmijëve të vizatojnë diçka me ngjyra të gjalla në pjesët boshe të letrës. Grupi, pasi t'i ketë mbledhur këto fletëpalosje, mund të bëjë disa gjëra, si, p.sh., t'ua të dërgojë me postë politikanëve lokalë për të nxitur përgatitjen dhe shpalljen e ndonjë deklaratë për punën e fëmijëve. Një mënyrë tjetër e përdorimit të fletëpalosjeve është realizimi i një konkursi apo dhe shitja e tyre në mënyrë që të mblidhen fonde për projektet për menjanimin e plotë të punës së fëmijëve.
- Organizoni një mbrëmje gjatë së cilës grupi mund të zhvillojë veprimtari të ndryshme. P.sh., mund të paraqesë një pjesë për punën e fëmijëve që është shkruar nga vetë të rinjtë. Mund të ekspozohen vizatime apo dhe punë të tjera artistike për punën e fëmijëve. Mund të këndohen këngë të shkruara nga vetë të rinjtë apo këngë të tjera, si dhe mund të shfaqet videoja e shkatërrimit të statujës prej letre. Në këto mbrëmje mund të ftohen: personalitete, personazhe të botës së sportit, të kulturës etj., në mënyrë që të zgjojnë tek ta interesin për dukurinë e punës së fëmijëve në kushtet e komunitetit ku jetojnë. Një ide tjetër është të improvizohen shitje me ankand të punimeve të bëra me temë punën e fëmijëve dhe një prej personazheve të drejtojnë ankandin.
- Krijoni rrjetin e të rinjve në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar që bashkëpunojnë për të luftuar kundër punës së fëmijëve. Gjithashtu, të rinjtë mund të bashkohen dhe të krijojnë rrjetin e tyre mbi bazën e tipit dhe llojeve të shkollave, klubeve sportive, rretheve të ndryshme të qendrave kulturore që janë në komunitet, që të ndihmojnë fëmijët e shfrytëzuar në punë. Nxitini pjesëtarët e grupit të fusin në grup të rinj të tjerë, të vendosin lidhje me shkolla të rretheve të tjera, madje edhe të vendeve të tjera. Botoni në revistat për të rinj dhe fëmijë, si dhe në median vizive dhe të shkruar gjithçka që bëni. Ndihmojini të rinjtë të kuptojnë se sa më shumë të jenë, aq më i fortë është zëri i tyre.



Vazhdimi

Pasi të keni zhvilluar një sërë veprimtarish ndërgjegjësuese, është e rëndësishme të përfshini grupin në organizmin e veprimtarive të mëtejshme. Hapi i parë është përgatitja e artikujve për gazetatat kryesore. Këta artikuj duhet të përgatiten menjëherë, pasi mediat kanë prirje t'i harrojnë shpejt ngjarjet. Një artikull i tillë pas disa ditësh do t'i kujtojë komunitetit veprimtaritë e zhvilluara, në të cilat ai ka marrë pjesë.

Grupi të shkruajë letra falenderimi për ata që morën pjesë dhe ndihmuan në realizimin e veprimtarive. Grupi të kuptojë se duke i falenderuar këta persona, do t'i detyrojë në një farë mënyre për t'i ndihmuar në të ardhmen. Kjo është thelbësore për një fushatë që duhet të vazhdojë gjatë.

Grupi, gjithashtu, të punojë për të dokumentuar gjithçka që bëhet në kuadër të projektit. Për këtë, caktojini detyra konkrete për dokumentimin e të gjitha veprimtarive në mënyrë që asgjë të mos mbetet jashtë kujtesës së projektit; përgatisni një dosje me copëza shkrimesh të gazetave; krijoni një album me fotografi të veprimtarive, takimeve dhe tryezave të rrumbullakta; mbledhni të gjitha burimet artistike dhe krijuese etj. Për të gjitha këto, caktoni afate konkrete në mënyrë që grupit të mos i humbë interesi. Ky dokumentacion të arkivohet dhe të ekspozohet në komunitet për një kohë të mjaftueshme. Madje grupi mund të vlerësojë edhe mundësinë që me materialet e arkivuara të zhvillojë ekspozita nëpër shkolla apo qendra të komunitetit për afërsisht 1 javë, në mënyrë që t'u krijojë mundësinë njerëzve të shikojnë dhe të vlerësojnë në tërësinë e vet projektin.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar

- Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë në veprimtari. Nëse dikush nuk paraqet interes, bisedoni dhe përpiquni të kuptoni se çfarë i intereson të bëjë. Nxitini të gjithë anëtarët e grupit të shprehin ide dhe bashkëpunoni me ta për t'i vënë ato në jetë.
- Mos u përpiqni të zbatoni pikë për pikë atë që thuhet në shtesën 1 të këtij moduli, bëhet fjalë vetëm për

një shembull që duhet përshtatur. Jepini mundësi zhvillimit të imagjinatës dhe krijmtarisë së lirë, pasi vetëm kështu mund të gjeni ide që mund të jenë të përshtatshme për mjedisin tuaj shoqëror, kulturor dhe të traditës. Studimi i trajtesës në shtesën 1 të shërbejë si katalizator për të nxjerrë në pah idetë që presin të zbulohen.

- Nëse keni mundësi, përdorni videokamerën ose aparatin fotografik.
- Mos u mundoni të zhvilloni veprimtari të shumta për të përfshirë komunitetin. Në varësi të mundësive dhe burimeve financiare, mund të zhvilloni disa prej tyre. Përzgjidhni ato veprimtari që janë më të përshtatshme për nevojat dhe rrethanat e grupit.
- Gjatë zhvillimit të sesioneve dhe ushtrimeve, mundohuni të krijoni një atmosferë të këndshme dhe me humor.
- Krijojini mundësi grupit të zgjedhë se çfarë duhet të bëjë dhe të përcaktojë nivelet e përgjegjesisë. Nuk duhet t'u impononi mendimet dhe dëshirat tuaja personave të veçantë dhe grupit. Përfshirja e komunitetit të jetë fryt i punës së përbashkët.
- Mos lejoni që njerëzit të tallen ose të kritikojnë të tjerët. Mbështesni fort qëndrimet pozitive.
- Lejoni të shkëmbehen batuta, të bëhet shaka, por gjithmonë duke i mbajtur nën kontroll.
- Në sallën ku do të bëhen mbledhjet me komunitetin apo do të zhvillohen veprimtari në kuadër të projektit, mundohuni të ekspozoni punime të realizuara gjatë zhvillimit të moduleve të tjera (kolazhe, krijime, vizatime, poezi, prozë, fotografi etj.).
- Sigurohuni që leksionet, të cilat trajtojnë çështjen e integrimit të komunitetit, të parapërgatiten me kujdes dhe të diskutohen gjallërisht.
- Sigurohuni që të gjitha veprimtaritë të dokumentohen me kujdes.
- Nxitini të rinjtë të shkruajnë letra falenderimi për personat që kanë marrë pjesë në veprimtaritë e zhvilluara. Nënvizoni rëndësinë që ka mbajtja e marrëdhënive të mira me komunitetin.
- Mos i vini të rinjtë e grupit në situata të vështira që mund të ndikojnë në rritjen e mosbesimit në aftësitë





e veta, p.sh., nëse nuk ka prirje për teatër, mos e detyroni të interpretojë. Secili pjesëtar i grupit të gjejë hapësirën e vet në mjedisin e grupit. Në vazhdimësi të verifikoni nëse të rinjtë ndiehen mirë në grup dhe e pëlqejnë atë çka bëjnë.

- Sigurohuni që të gjithë të rinjtë të marrin pjesë në shkrimin e letrave të falenderimit meqë kjo i shërben drejtpërdrejt rritjes dhe zhvillimit personal të të gjithë pjesëtarëve të grupit në planin shoqëror dhe komunikues.
- Gjatë veprimtarive që zhvillohen me komunitetin, mënjanoni elementet e garës.
- Menjëherë pas përfundimit të veprimtarive me komunitetin, organizoni një sesion diskutimi. Në përfundim të veprimtarisë është e drejtë që pjesëtarët e grupit të shprehen hapur rreth zhvillimit të veprimtarisë. Në disa raste, ata kanë nevojë të trasmetojnë entuziazmin dhe emocionet e tyre lirisht me besimin që grupi i mbështet. Ushtrime të tilla u japin mundësi të njiheni me emocionet që zotërojnë grupin, si dhe të përcaktoni hapat e mëtejshëm.

Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Në përfundim të veprimtarisë me komunitetin mbliidheni grupin në sallën apo në klasën e zakonshme dhe krijoni një mjedis çlodhës dhe të këndshëm. Mund të ftoni edhe persona të jashtëm që kanë marrë pjesë në realizimin e veprimtarisë. Flisni për veprimtarinë dhe nxisni diskutime rreth saj. Zbuloni se cila prej veprimtarive ka qenë më e këndshme dhe cila ka patur më pak entuziazëm. Mundësoni që të gjithë të shprehen lirshëm dhe pa doreza. Jepuni hapësirat e nevojshme pjesëtarëve të grupit që të shprehen lirshëm në lidhje me projektin për të ngjallur besimin dhe për të forcuar lidhjet ndërmjet tyre.

Nëse keni dokumentime në video, p.sh., ndonjë shfaqje teatrore, ky është momenti i përshtatshëm për ta shfaqur para grupit. Kjo do të krijonte një atmosferë çlodhëse për grupin, pasi të rinjtë do të qeshin me veten dhe me të

tjerët dhe do t'u tregohet si janë dukur para publikut. Do të kuptojnë më mirë ndikimin që ka patur shfaqja në publik dhe pse publiku ka reaguar në një mënyrë të caktuar. Ky është një moment shumë i rëndësishëm i projektit. Nxitini të bëjnë komente rreth asaj që shikojnë në video nëse ka ndonjë gjë që duhej të bëhej ndryshe; nëse mendojnë se kanë lënë mbresa në komunitet a në ç'mënyrë shfaqet interesi që ka treguar komuniteti; nëse mendojnë se kanë arritur të tërheqin mbështetjen e komunitetit dhe ç'duhet të bëjnë tjetër për të shfrytëzuar këtë mbështetje.



Analizoni së bashku artikujt që janë shkruar se ç'reagimesh ka grupi ndaj këtyre artikujve. Krijoni mundësi që të gjithë të shprehen për përfundimet. Kërkojuni të rinjve të shprehen dhe të vlerësojnë vazhdimin e veprimtarisë. Ndoshta ndonjëri shikon mundësinë e zhvillimit të veprimtarive të tjera, në vazhdim të punës së kryer.

Së fundi, është e rëndësishme që grupi të kuptojë se gjithçka që është bërë, është në kuadrin e fushatës botërore për eliminimin e plotë të punës së fëmijëve. Pjesa më e madhe e grupit ka marrë pjesë me dëshirë në këto veprimtari. Nuk ka asgjë të keqe nëse i pyesni rreth temës së punës së fëmijëve dhe diskutoni me ta situatën e vështirë në të cilën ndodhen këta fëmijë. Gjithashtu, kërkojuni atyre të shprehen si kanë ndihmuar në çështjen e punës së fëmijëve nëpërmjet realizimit të veprimtarisë që kanë zhvilluar nëse kanë qenë në gjendje të mbledhin fonde. Nëse përgjigjja është pozitive, vazhdoni më tej sesi mendojnë ata t'i shpenzojnë këto para për të ndihmuar fëmijët që punojnë; a kanë ndonjë mendim për këtë; a kanë ndonjë ide të re; ç'mendojnë se do të ndodhë tani; a ndiehen të kënaqur për punën që kanë kryer nëse dëshirojnë të bëjnë diçka më shumë; a besojnë se do ta ruajnë në mendjen e vet dhe do të përpiqen ta shpërndajnë mesazhin e veprimtarisë së zhvilluar; a do t'i bëjë përvoja e jetuar më të ndërgjegjshëm për dhunimin e të drejtave të njeriut dhe shfrytëzimin e fëmijëve etj.

Përdoreni këtë sesion përfundimtar të projektit si një moment reflektimi të përgjithshëm dhe personal (për të gjithë grupin dhe për secilin pjesëtar të tij), duke nxjerrë në pah vlerat e projektit për grupin dhe për individë të veçantë.

Vlerësimi dhe vazhdimi

Për vlerësimin e veprimtarive të zhvilluara me komunitetin, ka tregues të ndryshëm ku bëjnë pjesë:

- llojet e ideve që janë zhvilluar;
- llojet e veprimtarive të zhvilluara;
- veprimtari që kanë mundësuar zhvillimin e programit;
- prurjet e komuniteteve të ndryshme;
- niveli i ndërgjegjësimit i komuniteteve të ndryshme;
- pasqyrimi mediatik i veprimtarive.

Sigurisht që ekzistojnë edhe tregues të tjerë, por, nëse kriteret e sipërpërmendura janë arritur, kjo do të thotë se grupi ka punuar mirë dhe ju duhet t'ia thoni këtë. Veprimtaritë e sensibilizimit, si ato të rastit konkret, mund të jenë të këndshme dhe interesante për të rinjtë. Nga ana tjetër, këto veprimtari shërbejnë për të arritur objektivin dhe kanë njëkohësisht një ndikim të fuqishëm në komunitetet që përfshihen.



Ky modul është i fundit për grupin tuaj dhe është një mënyrë shumë e mirë për të mbyllur projektin. Moduli i jep mundësi grupit të vërë në jetë njohuritë, shprehitë dhe shkathtësitë që ka fituar gjatë realizimit të projektit. Gjithashtu, ju jep mundësi të vlerësoni punën e kryer dhe është si të thuash testi përfundimtar i suksesit, pasi baza në të cilën mbështete ky projekt, është ndërgjegjësimi dhe përgjegjësimi i të rinjve si aktorë shoqërorë të rëndësishëm që sjellin lëvizjen dhe ndryshimin. Suksesi që do të keni në trasmetimin e qartë të këtij mesazhi komunitetit, varet kryesisht nga ndikimi që ka patur realizimi i moduleve dhe mënyra si janë zhvilluar. Ia vlen të theksojmë se objektivi kryesor i projektit është të ndryshojë sjelljen dhe qëndrimin jo vetëm të të rinjve të grupit ndaj punës së fëmijëve, por edhe të përfaqësuesve të komunitetit në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Shtesa 1

Përfshirja e komunitetit në Republikën e Irlandës (studimi i një rasti konkret)

Meqë realizimi i këtij moduli mund të paraqesë vështirësi në varësi të kushteve të vendeve ku zbatohet, po japim një shembull ushtrimi të përfshirjes së komunitetit që është realizuar në Republikën e Irlandës, në fazën e provës së modulit. Qysh në fillim të projektit, opinioni u informua gjerësisht për përmasat e kësaj nisme. U botuan artikuj në shtypin lokal, u realizuan intervista në radiot lokale. Si pjesë e procesit edukativ, studentët u përfshinë në një veprimtari paraprake, si: punë kërkimore për dukurinë e punës së fëmijëve nëpërmjet internetit, intervista me politikanë lokalë, shkrim i letrave për përfaqësues të qeverisë, të autoriteteve lokale, sindikatave dhe OJF-ve, si dhe personaliteteve të ndryshme.

Në bibliotekën e lokale, të rinjtë ngritën një kënd me materiale për punën e fëmijëve, si dhe për çështje të tjera që lidhen me të. Shumë nga këto materiale u nxorën nga fondi i bibliotekës. Kjo veprimtari u dha mundësi të rinjve dhe personave të tjerë që u përfshinë në këtë kërkim, të lexonin materiale të shumta për punën e fëmijëve, si dhe të nxirrnin në pah probleme që lidhen me të. Kjo veprimtari u hapi të rinjve horizontin në lidhje me problemin, si dhe i ndihmoi shumë për modulin "Kërkimi dhe informacioni". U organizua një debat me temën: " Fëmijët i perkasin shkollës, jo punës", me nxënësit e shkollës dhe me një anëtar të qeverisë lokale. Të rinjtë organizuan një konkurs kushtuar programit "SCREAM" me postera. Realizuan mbledhjen e fondeve për reabilitimin e fëmijëve që punonin në Nepal, nëpërmjet organizimit të një feste në diskotekë. Në bashkëpunim me një shkrimtar dhe një piktor realizuan një krijim dhe një çarçaf të pikturuar me vizatime që lidhen me punën e fëmijëve.

Gjithashtu, të rinjtë punuan me një dramaturg të teatrit lokal për të bërë një shfaqje teatrore për punën e fëmijëve. Shfaqja la gjurmë të thella si tek të rinjtë që interpretuan, ashtu dhe te shokët e tyre dhe në trupën pedagogjike të shkollës. Megjithatë, shfaqja e dhënë në shkollë nuk arriti të realizonte tërësisht objektivat e vet, të cilat kishin të bënin me ndërëgjegjësimin e komunitetit, si dhe t'u siguronte të rinjve mjetet për t'i komunikuar një publiku më të gjerë njohuritë që ata kishin marrë gjatë realizimit të moduleve.

Pasi kishim ndërëgjegjësuar grupin e të rinjve dhe kishim nxitur krijimtarinë dhe dinamizmin e tyre, menduam se do të ishte e dobishme t'u jepnim mundësi të shprehnin emocionet dhe motivimin e tyre ndaj këtij problemi. Grupi i bashkërendimit të projektit mendoi se suksesi i provës duhet të ndahet me komunitetin, veçanërisht me një numër të madh mësuesish dhe edukatorësh,

me personazhe që kanë fuqi vendimmarrëse, si dhe me persona të tjerë që janë të interesuar për problemin si brenda, ashtu dhe jashtë vendit, me qëllim që të nxirrej në dukje se çfarë janë në gjendje të bëjnë të rinjtë nëse nxiten ndiehen të mbështetur.

Ashtu siç thuhet në udhëzuesin për realizimin e moduleve, grupi i të rinjve dhe mësuesit që i udhëhoqën, duhet të jenë ambiciozë në kërkesat e tyre. Nëse mësuesit nuk janë të tillë, procesi nuk mund të zhvillohet me të gjithë forcën e vet. Përvoja ka treguar se të rinjtë janë të aftë të realizojnë me cilësi një projekt nëse ndiehen të mbështetur dhe nxiten nga mësuesit.

Në lidhje me këtë rast, edukatorët diskutuan me grupin mundësitë e shumta të përfshirjes më të madhe të komunitetit. Mbi bazën e ballafaqimit të ideve u vendos të plotësohet projekti me organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuere gjatë një jave duke përfunduar me një shfaqje teatrore që u zhvillua në një sallë me hyrje të lirë për të gjithë komunitetin.

Java ndërgjegjësuere

Nga grupi u kërkua që të bënte programin e veprimtarive ndërgjegjësuere, që është si më poshtë:

Mjetet e komunikimit

U përcaktuan tri mjete të komunikimit, nëpërmjet të cilave do të jepej lajmi për këtë javë ndërgjegjësuere: gazeta e kishës, radioja dhe televizioni lokal.

- **Kisha**

Në Irlandë, kisha luan një rol shumë të fuqishëm në komunitet, veçanërisht për komunitetet lokale. Çdo kishë boton buletin e vet. Iu kërkua priftërinjve që në buletin të njoftonin programin e javës ndërgjegjësuere. Disa prej priftërinjve e lexuan këtë njoftim në fund të shërbesave fetare.

- **Gazetat e qarkut**

Një javë para zhvillimit të veprimtarive, në gazetat e qarkut u botuan artikuj që flisnin për punën e fëmijëve. Gjithashtu, me ndihmën e një piktori lokal u botua dhe një spot me të gjithë programin e javës ndërgjegjësuere.

Përveç botimit të artikujve të mëparshëm, si dhe të informacionit për veprimtaritë e javës ndërgjegjësuere, më pas u botuan artikuj për atë çka ishte zhvilluar.

● Radiot lokale

Një java para zhvillimit të veprimtarive të javës ndërgjegjësuere, një njoftim i veçantë publicitar ishte përgatitur me zërat e të rinjve dhe u trasmetua për 5 ditë rresht. Zërat jepnin statistika për punën e fëmijëve dhe theksonin idenë se puna e fëmijëve vazhdon si rrjedhojë e indiferencës së shoqërisë kundrejt fatit të miliona fëmijëve në botë.

Edukimi i bashkëmoshatarëve.

Jo rrallë edukimi ndërmjet të barabartëve dhe moshatarëve sjell rezultate më të mira. Në rastin konkret, të rinjve iu dha mundësia që vetë të zhvillonin një modul dhe për një ditë të bëheshin mësues.

Këto sesione u zhvilluan pasi u bisedua me drejtorët e dy shkollave fillore. Dy klasa me fëmijë të moshës 11 dhe 12 vjeç u përfshinë në një sesion didaktik për 90 minuta.

Për t'u realizuar, u zgjodh moduli i kolazhit. Ky është një modul veçanërisht i përshtatshëm për fëmijët e vegjël. Secilit fëmijë ditë më parë iu shpërnda moduli që ta lexonte për të qenë i përgatitur për të planifikuar seancën. Në të gjitha rastet, njëri kontrollonte zhvillimin e punës, ndërsa pjesëtarët e tjerë të grupit i ndihmonin fëmijët të realizonin kolazhin. Para se të fillonte realizimi i modulit, u paraqit përpara pjesëmarrësve dhe më pas u hap një debat për punën e fëmijëve. Të rinjtë iu tha të ndaheshin në grupe dhe të siguronin materialet e nevojshme. Pas përgatitjes së kolazheve, punimet u varën në muret e klasës dhe detyra e të rinjve ishte të gjenin titullin e secilit prej tyre. Në rastin e kolazheve me përmbajtje punën e fëmijëve, grupet që i kishin përgatitur, u ftuan të shpjegonin se çfarë kishin dashur të shprehnin me këtë kolazh dhe pse kishin zgjedhur pikërisht këtë imazh apo fotografi. Këto punime u ruajtën dhe u ekspozuan në takimin e përjavshëm të së shtunës mbrëma.

Nga të gjitha veprimtaritë e projektit, kjo e fundit ishte më e suksesshme në planin e rritjes së përgjegjësisë së të rinjve, madje edhe në manaxhimin e modulit nga ana e të rinjve. Kjo veprimtari krijoi një ndjenjë të fortë vetëvlerësimi në mes të pjesëmarrësve.

Tryeza e rrumbullakët

U organizua një tryezë e rrumbullakët me temë “Nga shtëpitë e riedukimit në tregun e punësimit” për punën e fëmijëve në të shkuarën në East Clare (East Clare është një rajon në bregun perëndimor të Irlandës ku u pilotua projekti).

Sot Irlanda është një vend i zhvilluar, por jo shumë kohë më parë ishte një vend i varfër dhe i trazuar nga problemet politike, socialekonomike si shumë vende në botë. Në East Clear ende jetojnë njerëz që në fëmijërinë e tyre kanë punuar. Një ndër praktikat më të përdorura ishte kërkimi i fuqisë punëtore me çmim të ulët në kohën e mbledhjes së prodhimeve bujqësore. Fëmijët që punonin, u sigurohej ushqimi e fjetja. Në përfundim të punës ktheheshin në shtëpitë e tyre me një shpërblim shumë të vogël.

Për të siguruar lidhjen ndërmjet realitetit të Irlandës së shkuar dhe situatës së shumë vendeve ku shfrytëzohet puna e fëmijësve sot, në këtë tryezë mori pjesë edhe një historian dhe si moderator i tryezës ishte një ish-drejtor shkolle i dalë në pension. Njëri prej pjesëmarrësve foli për shtëpitë e riedukimit, ndërsa tjetri foli për tregun e punësimit në të kaluarën. Kjo ngjarje ballafaqoi mendimet dhe idetë ndërmjet gjeneratave që jo rrallë kanë mosmarrëveshje.

Ndeshja e zemrës: “Puna e fëmijëve” kundrejt “Indiferencës botëror”

Meqë një pjesë e të rinjve të grupit ishin tifozë futbollli, u propozua që të luanin një “ndeshje të zemrës”. Qëllimi kryesor i saj ishte të mblidhte në një ndeshje miqësore dhe të këndshme personalitete të vendit që përfaqësonin interes për publikun. Diskutimet në klasë u përqendruan në përzgjedhjen e personazheve që duhet të takonin dhe të ftonin, përfaqësues të skuadrës kombëtare të regbisë apo të hurlingut (një sport tradicional irlandez), lojtarë të përfaqësueses irlandeze të futbollit, kalorës të sportit të hipizimit apo dhe përfaqësues të botës së hipizmit, si dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit, duke përfshirë dhe drejtorin dhe mësues të shkollës së grupit të të rinjve.

Për pjesën më të madhe të të rinjve, ndeshja ishte veprimtaria më e rëndësishme e javës. Dy skuadra, njëra e quajtur “Puna e fëmijëve”, e përbërë nga nxënësit që merrnin pjesë në projekt, dhe tjetra e quajtur “Indiferenca botërore”, e përbërë nga presonalitetet e ftuara, u ndeshën në një takim të quajtur i pabarabartë. Pavarësisht epërsisë së skuadrës së “Indiferencës botërore”, loja u drejtua në mënyrë të tillë që të përfundonte në barazim. Për të shpallur skuadrën fituese, u gjuajtën penalltitë që u fituan nga skuadra “Puna e fëmijëve”, që në mënyrë simbolike do të ishte mesazhi i shpresës për të bërë gjithçka për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Gjuqtar i ndeshjes, një figurë sportive e njohur në nivel lokal, ishte dhe mësues në shkollën fillore.

Ishte ftuar një gazetar sportiv, i cili me një altoparlant bëri komentimin e ndeshjes. Ishte shumë interesante mënyra humoristike e komentimit të ndeshjes nga gazetari. Kjo ndeshje pati jehonë edhe në median lokale. Fotografia i një gazete lokale botoi fotografi të personazheve të njohura, si dhe fotografi të fëmijëve që organizuan veprimtarinë.

Falë njoftimeve të afishuara ngado, si dhe të njoftimeve edhe në media, në këtë ndeshje mori pjesë një publik i larmishëm nga të gjitha moshat, madje edhe nga komunitetet përreth. Pas ndeshjes, personalitetet morën pjesë në një pritje ku patën mundësi të flisnin me median dhe fëmijët. Kjo ka qenë një veprimtari shumë e suksesshme, e cila rriti dinamizmin e grupit, duke përforcuar identitetin e të rinjve si luftëtarë të luftës kundër punës së fëmijëve.

Shfaqje teatrore

Gjatë javës, krahas zhvillimit të veprimtarive ndërgjegjësuese, grupi u përfshi edhe në provat për shfaqjen teatrore. Një ditë para ngjarjes kryesore, grupi bëri provat përfundimtare me kostume, ku u ftuan dhe pjesëtarët e komunitetit. Shfaqja ishte me shumë ngarkesë dhe e preku thellë publikun. Disa nga pjesëmarrësit qanën, të tjerë heshtën nga emocionet e forta që provuan. Pati edhe të tjerë që u ndihën keq. Gjithësesi, secili u parball me një dukuri për të cilën nuk kishte menduar thellë.

Në një përpjekje tjetër për t'ia bërë të njohur komunitetit dhe për ta përfshirë atë, grupi ftoi fëmijët e shkollës fillore jashtë sallës së komunës ku zhvillohej shfaqja, të interpretonin rolin e fëmijës që punon.

Ndërkohë, i gjithë grupi ishte veshur me të zeza dhe me maska të bardha (të përgatitura nga vetë fëmijët me ndihmën e një artisti). Maskat paraqisnin indiferencën e shoqërisë ndaj dhimbjes dhe vuajtjes së fëmijëve që punojnë. Ato përfaqësonin fatin e miliona fëmijëve që vuajnë çdo ditë. Nga ana tjetër, grupi u argëtua duke mësuar për funksionin e maskave teatrore, duke kuptuar vlerën dhe forcën që kanë maskat kur përdoren për një qëllim të caktuar.

Më pas, publikut që ndiqte teatrin e rrugës, iu lejua të hynte në sallë. Njerëzit hynë një nga një dhe shoqëroheshin nga një njeri me maskë deri sa uleshin në vendin që zgjidhej rastësisht. Çiftet zakonisht ndaheshin, ndërsa fëmijëve u lejohej të qëndronin pranë prindërve, por asnjëri nuk duhej të fliste. Nëse dikush fliste, një njeri me maskë i afrohej dhe i bënte shenjë të heshte. Qëllimi ishte të mbanin të gjithë publikun në një farë tensioni dhe të dëshmonin si duhej të ndihej një fëmijë i vogël, kur lihej në një gjendje të vështirë, vetëm, në errësirë, i ndarë nga shokët ose familja, i rrethuar nga zhurmat misteroze të punës dhe i nënshtuar ndaj urdhrave që vinin nga persona me një fytyrë tërësisht indiferente ndaj tyre.

Në brendësi të sallës, muret ishin mbushur me tablo të një piktori lokal. Po në mure ishte vendosur mbulesa e vizatuar nga vetë fëmijët. Dritaret ishin zënë me perde dhe mjedisi ishte errësuar. Muzika, e përzgjedhur për të sjellë një atmosferë mbytnë, ekzekutohej nga instrumentistët e shkollës lokale.

Pasi publiku zuri vend, para se të fillonte shfaqja, të gjitha maskat u rreshtuan përpara skenës dhe morën një pozë të caktuar. Ashtu siç theksohet në modulin e dramatizimit, skenografia ishte shumë e thjeshtë.

Artistët e rinj vazhduan të ishin të veshur me të zeza, por hoqën maskat vetëm pas perdeve.

Në përfundim të provës përfundimtare me kostume, artistët e rinj, regjizori dhe grupi i bashërendimit u takuan me prindër dhe shikues të ndryshëm që ishin shumë entuziastë për shfaqjen dhe dëshironin t'i mbështesnin. Disa njerëz u emocionuan aq shumë, sa nuk arrinin të flisnin. Vetëm atëhere grupi filloi të kuptojë se ç'përshtypje të madhe kishte bërë pjesa tek publiku dhe që në një farë mënyre, projekti ia kishte arritur qëllimit, diçka kjo që ngjalli ndjenjën e krenarisë dhe fitores tek të rinjtë.

Mbrëmja kulturore

Veprimtaria kryesore e javës ndërgjegjësuere ishte shfaqja teatrale. Kjo u bë në kuadër të një mbrëmjeje të veçantë që filloi me shfaqjen teatrale dhe vazhdoi me një debat për përvojën irlandeze dhe botërore në lidhje me punën e fëmijëve.

Mbrëmja ishte një rast shumë i mirë për të paraqitur projektin dhe për t'u referuar si model shumë i mirë i punës që nxit dhe mbështet aftësitë krijuese dhe imagjinues të të rinjve në kuadër të fushatës botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Po me këtë rast, u organizua një pritje, e cila, para se të fillonte, ishte menduar të zhvillohej në përfundim të shfaqjes një sekuencë që do të karakterizohej nga një farë tensioni deri në momentin që do të zhvillohej pritja. Në përfundim të shfaqjes, të rinjtë rivunë maskat dhe u rreshtuan në të dyja anët e daljes. Në këtë mënyrë, në dalje, publiku u përball me të njëjtat maska që tashmë i lidhte me të keqen që u sillnin fëmijëve që punonin. Grupi me maska i shoqëroi të gjithë pjesëmarrësit në pritje.

Edhe një herë, grupi i të rinjve aktorë u përball me shprehjen e opinionëve dhe të ndjenjave të publikut në lidhje me shfaqjen teatrale. Pas shfaqjes, foli një ministër, një përfaqësues i IPEC-ut dhe një përfaqësues i të rinjve pjesëmarrës. Nga kjo përvojë, të rinjtë dolën shumë të emocionuar dhe entuziastë. Përsa u përket të ftuarve, dukej menjëherë që mbrëmja ia kishte arritur qëllimit, pasi pati një ndikim fantastik mbi ta, madje edhe për ato personazhe që kishin pushtet, të cilët shprehën mendimin që do të mbështesnin

realizimin e projektit.

Në lidhje me reklamën mediatike, dy gazeta kombëtare dhe një lokale i bënë jehonë veprimtarisë dhe javës së ndërgjegjësimit. Një gazetar i radios intervistoi atë natë të ftuar të rëndësishëm, si dhe përfaqësues të grupit. Copëza të këtyre intervistave u trasmetuan edhe në radion lokale.

Shënime

A series of horizontal dotted lines for writing notes.

